



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

QERSHOR 2017

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërin prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja. Me fat!

Me fat!



* A 7 6 8 5 7 *

FAQE E ZBRAZËT

Duke u bazuar në një fragment nga libri “Malli për jetën”, përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Eteni ishte një qytet i vogël dhe njerëzit e shikonin me përçmim Vinsentin. Nuk i zinin besë dhe ia kishin frikën sepse ishte ndryshe, megjithëse nuk i pengonte aspak në punët e tyre dhe e vetmja gjë që kërkonte ishte që ta linin të qetë. Vinsenti as nuk e merrte me mend që njerëzit nuk e donin.

Duke vizatuar një studim të gjerë të pyllit të pishës, të cilin ishin duke e prerë, ishte përqendruar te një pemë e vetmuar në cep të shpatit. Njëri prej punëtorëve, duke e lënë punën, i afrohej shpesh për ta parë si vizatonte; e shikonte përmbi krah, duke përmbajtur të qeshurit, por herë pas here ia kryste gazit me zë. Nga dita në ditë fshatari qeshej me zë gjithnjë më të lartë. Vinsenti vendosi ta kuptonte çka po e argëtonte fshatarin aq shumë.

- Ju duket qesharake – filloi me maturi - që po vizatoj një pemë?

Njeriu zgërdhihej. – Po, po, është aq qesharake. Ju jeni me siguri *fou!**

Vinsenti ra në mendime për pak çaste, pastaj e pyeti:

- A do të isha fou sikur ta mbillja një pemë?

Fshatari përnjëherë u bë serioz. – Oh, jo, në asnjë mënyrë.

- Po sikur ta kultivoja pemën dhe të kujdesesha për të, a do të isha fou?

- Jo, kuptohet se jo.

- Po sikur të vilja fruta prej tij, a do të isha fou?

- Ju po talleni me mua!

- Mirë, po a do të isha fou sikur të prisja pemët siç po veprojnë ata atje poshtë?

- Oh, jo, pemët duhet prerë.

- Domethënë, mund ta mbjell pemën, ta kultivoj, ta vjel, ta pres, por kur e vizatoj – atëherë jam fou. A është kështu?

Fshatari përsëri ia kriski gazit. – Po, sigurisht që jeni fou kur rrini aty, i gjithë fshati ashtu thotë.

Në mbrëmje Vinsenti ulej në trapezari me të vetët. Gjithë familja mbledhej rreth tryezës së rrumbullakët; dikush qepte, dikush lexonte, dikush shkruante letra. Vëllai i vogël i Vinsentit, Kori, ishte një fëmijë i urtë, që fliste rrallë. Njëra prej motrave të tij, Ana, ishte martuar dhe shpërngulur. Elizabeta nuk e duronte shumë, prandaj shtirej sikur nuk e kishte vërejtur ardhjen e tij në shtëpi. Vilemina ishte e dashur; i pozonte Vinsentit sa herë që ky e luste, dhe i ofronte miqësi të sinqertë, pa e paragjykuar.

Vinsenti punonte gjithashtu pranë tryezës, ndihej mirë nën dritën e llambës së madhe me ngjyrë të verdhë, e cila gjithmonë ishte në mes të tryezës. I fshinte figurat e ushtrimit ose skicat të cilat i kishte punuar atë ditë, në fushë. Teodori e ndoqi se si dymbëdhjetë herë e vizatoi të njëjtën gjë dhe pastaj i pakënaqur e hodhi vizatimin e përfunduar; në fund, prifti e humbi durimin.

- Vinsent – tha, duke u përkulur mbi tryezën e gjerë – a nuk ia del dot ta vizatosh saktë?

- Jo – u përgjigj Vinsenti.
- Atëherë, druaj se ke bërë një gabim.
- Unë bëj shumë gabime, at. Për cilin gabim e ke fjalën?
- Më duket se sikur të kishe talent, sikur vërtet të ishe lindur për piktor, ato vizatime do të duhej të dilnin mirë që në përpjekjen e parë.

Vinsenti shikoi studimin e një fshatari ulur në gjunjë para thesit ku i hidhte patatet. Iu duk se nuk e kishte qëlluar mirë linjën e dorës së lypësit.

- Ndoshta, at.
- Doja të them – nuk do duhej të vizatosh gjithçka njëqind herë, e prapë të mos e vizatosh saktë. Po të ishe i talentuar, do ta bëje pa u lodhur aq shumë.
- Natyra në fillim gjithmonë e kundërshton artistin, at, - tha ai, pa e ulur lapsin – por nëse punën time e marr seriozisht nuk do të lejoj që ai kundërshtim të më pengojë. Do bëj të kundërtën, kjo gjë do të jetë një arsye më shumë për mua që të luftoj deri në fitore.
- Nuk pajtohem – tha Teodori. – e mira kurrë nuk del nga e keqja, as nga puna e keqe nuk mund të dalë një vepër e mirë.
- Ndoshta jo në teologji. Por në art mund të ndodhë.
- E ke gabim, biri im, vepra artistike ose është e mirë, ose e keqe. Nëse është e keqe, njeriu në atë rast nuk është fare artist. Do të ishte mirë që ai këtë përfundim ta nxirrte që në fillim, e jo të çojë dëm aq shumë kohë dhe djersë.
- Po në qoftë se ai person ndihet i lumtur falë atij arti të keq? Si thua?

Teodori hulumtoi njohuritë e veta teologjike, por nuk gjeti përgjigje në atë pyetje.

- Jo – tha Vinsenti, duke e fshirë thesin me patate dhe duke e lënë të ngrirë në ajër dorën e ngritur të lypësit – në fund natyra dhe artisti i vërtetë gjithmonë pajtohen. Ndoshta do të duhen shumë vite dhe kacafytje që ajo të zbutet dhe të nënshtrohet, por në fund vepra e keqe do të shndërrohet në vepër të mirë dhe do ta arsyetojë vetveten.
- Po çka do të ndodhë nëse vepra mbetet e keqe deri në fund? Me ditë të tëra e ke vizatuar njeriun tënd të ulur në gjunjë, e ai ende nuk vlen. Imagjino sikur të vazhdosh ta vizatosh me vite e vite, e ai të mbetej gjithmonë i keq.

Vinsenti rrudhi me krahë. – Artisti rrezikon, at!

- Po a ia vlen shpërblimi gjithë atë rrezik?
- Shpërblimi? Cili shpërblim?
- Lekët që fiton njeriu. Dhe statusi në shoqëri.

Vinsenti për herë të parë e ngriti shikimin dhe vështroi vijat në fytyrën e plakut, një nga një, sikur të shikonte një qenie të huaj.

- Mendova se po flisnim për veprat e mira dhe të këqija artistike – tha ai.

(fragment nga libri „Malli për jetën” i Irving Stone-s, Alnari, 2007)

**Fjalë më pak e njohur:*

fou – (frëngj.) - i marrë

1. Banorët e Etenit e shikojnë me përbuzje Vinsentin për arsye se:

1. kanë përvojë të keqe me njerëzit nga viset e tjera
2. kanë frikë nga gjithçka që është e panjohur dhe ndryshe
3. Vinsenti nuk merret me ta, prandaj mendojnë se i shpërfill
4. u përket shtresave të larta të shoqërisë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

2. Vinsenti nuk e gjen dashurinë dhe mirëkuptimin e nevojshëm të familja e vet. Kush bën përjashtim?

1 pikë

3. Vinsenti është artist i dobët sepse vazhdimisht i fshin ato që vizaton?

PO

JO

Rretho përgjigjen e saktë (PO ose JO) dhe argumentoje.

1 pikë

4. Përgjigja Jo e Vinsentit do të thotë:

1. Nuk kam sukses, sepse ende nuk e zotëroj shkathhtësinë e të vizatuarit.
2. Nuk kam sukses, sepse vizatoj ashtu siç i përjetoj unë gjërat.
3. Nuk kam sukses, sepse nuk jam i talentuar.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

5. A) Çfarë gjen Vinsenti kur merret me art?

1. kënaqësinë
2. të holla
3. statusin në shoqëri

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

B) Gjeje argumentin në tekstin e përgjigjes.

1 pikë

6. “Vinsenti për herë të parë e ngriti shikimin dhe vështroi vijat në fytyrën e plakut, një nga një, sikur të shikonte një qenie të huaj. “

Kjo fjali përshkruan se Vinsenti ndjen:

1. frikë
2. habi
3. qetësi
4. indiferencë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

7. Duke u bazuar në tekst, sqaro dallimin ndërmjet artit dhe teologjisë.

2 pikë

Lexo tekstin në vijim, pastaj zgjidhi detyrat 8, 9 dhe 10.

Kur helenët u mbledhën në Istëm dhe vendosën që së bashku me Aleksandrin të nisen në luftë kundër Persisë, e caktuan atë për prijës suprem ushtarak. Me atë rast vinin tek ai shumë burra shteti dhe filozofë për t'i dëshiruar sukses dhe fat. Aleksandri shpresonte që ashtu do të vepronte edhe Diogjeni i Sinopit, i cili në atë kohë ishte afër Korintit. Mirëpo pasi që Diogjeni nuk i jepte fare rëndësi kësaj pune, por pushonte i qetë në Kranej, shkoi personalisht tek ai. Ishte pikërisht koha kur Diogjeni rrezitej në Diell. Duke vënë re turmën që po i afrohej, ai paksa u drejtua dhe ktheu shikimin në drejtim të Aleksandrit. Ky e përshëndeti me mirësjellje dhe e pyeti a mund të bënte diçka për të. “Lëviz pak nga ai vend, se po ma zë diellin!”, iu përgjigj Diogjeni. Thonë se Aleksandri u befasua shumë dhe, pa marrë parasysh se ai njeri nuk e përfilli, u habit me krenarinë dhe madhësinë e tij shpirtërore. Dhe derisa përcjellësit e tij, gjatë kthimit, talleshin dhe flisnin gjëra për të qeshur, ai u tha: “Me të vërtetë, po të mos isha Aleksandër, do të isha Diogjen”.

Aleksandri i Maqedonisë (356 – 323. para e.s.), ose Aleksandri i Madh, ishte mbret i maqedonasve, konsiderohet si njëri prej personaliteteve më të rëndësishme të historisë së gjithëmbarshme greke.

Diogjeni i Sinopës, filozof grek, është përfaqësuesi më i njohur i shkollës sokratiane të cinizmit.

(përgatitur sipas: *Plutarku, Jetët paralele*)

8. Përse shkoi Aleksandri te Diogjeni?

1. Kishte dëshirë ta dëgjonte mendimin e Diogjenit lidhur me fushatën e vet të re luftarake.
2. Donte t'i tregonte se i kishte mbetur hatri për shkak të mosardhjes dhe mungesës së respektit nga ana e tij.
3. Donte të dinte kush ishte ai njeri që nuk kishte ardhur për t'i uruar sukses para nisjes në luftë.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

9. Cilat tipare i shfaq Diogjeni gjatë takimit me Aleksandrin?

1. mendjemprehtësi dhe respekt
2. indiferencë dhe krenari
3. vetëpërmbytje dhe frikë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

10. Shpjego fjalët e Aleksandrit: “Me të vërtetë, po të mos isha Aleksandër, do të isha Diogjen!”

1 pikë

Lexo fragmentin nga drama “Duke pritur Godonë” të Semjuel Beketit pastaj zgjidhi detyrat 11 dhe 12.

Rrugë fushore, me një dru. Mbrëmje. Estragoni rri në tokë dhe provon ta z bathë këpucën. Përpiqet me të dyja duart, duke shfryrë. I mbetur pa fuqi, ndalet. Pushon, i është marrë keq fryma. Provon përsëri në të njëjtën mënyrë. (...)

Estragoni, me një përpjekje të fundit, të madhe, ia del ta z bathë këpucën. Shikon brenda, e fut dorën si të kërkonte diçka, e kthen mbrapsht, kërkon mos ka rënë gjë poshtë në tokë, nuk gjen asgjë, e fut përsëri dorën në këpucë, me shikimin pa kurrfarë shprehje.

VLADIMIRI: Ç’ke?

ESTRAGONI: Asgjë.

VLADIMIR: Ma jep ta shoh.

ESTRAGONI: S’ka asgjë për të parë.

VLADIMIRI: Provo ta mbathësh prapë.

ESTRAGONI (*pasi e këqyri shputën*): Po e lë këmbën të marrë frymë.

VLADIMIRI: Shiko çfarë njeriu është: i mban mëri këpucës së vet, ndërsa fajtori i vërtetë është këmba e tij.

(*Përsëri e heq borsalinën, shikon brenda, pastaj e vendos prapë në kokë.*) Kjo veç po më brengos.

(Heshtje.)

11. Çfarë lloj drame është vepra “Duke pritur Godonë”?

1. komedi
2. tragjedi
3. dramë e absurdit
4. dramë në kuptim të ngushtë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

- 12.** Pranë elementeve të dramës që janë të pranishme në këtë fragment rretho përgjigjen PO, ndërsa nëse mungojnë rretho përgjigjen JO dhe arsyetoje përgjigjen.

ELEMENT I DRAMËS	PO JO	ARSYETIMI I PËRGJIGJES
skena	PO JO	
ngjarja	PO JO	
konflikti	PO JO	

2 pikë

Kujto baladën e lashtë ROZAFATI dhe përgjigju pyetjeve 13 dhe 14

- 13.** Rretho përgjigjen SAKTË nëse mendon se thënia në vijim është e saktë, ose PASAKTË nëse mendon se nuk është e saktë.

Në baladën popullore ROZAFATI të gjithë vëllezërit e mbajnë besën që lidhën për të mos u treguar bashkëshorteve të veta vendimin që kanë marrë?

SAKTË

PASAKTË

Arsyeto përgjigjen.

1 pikë

14. Shpjego kuptimin e vargjeve:

N'daçi drejt ju me punue,
Të diellën mos punoni,
Lidhni besë e lidhni fe,
Në konak mos bisedoni,
Vashavet mos u kallxoni!
Nesër nadje t'zbardhmen drita,
Cilla vashë t'i u bjerë bukën,
At muronje n'mur t' kalas'
E atëherë keni me pa,
Se kalaja vend ka xanë.

3 pikë

15. Fjalinë e dhënë më poshtë kaloje nga ligjërata e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë.

Mësuesi, shumë i entuziazmuar, i tha: „Përgjigjja jote është shumë e saktë“.

1 pikë

16. Në cilat pjesë të ligjëratës (emër, mbiemër... etj.) bëjnë pjesë fjalët e nënvizuara? Shkruaj përgjigjet mbi vijat e parapa.

Korelacioni me mësimin e shkencave natyrore dhe informatikën u ndihmon nxënësve në përvetësimin e shkathtësive të cilat i ofron jeta në epokën postindustriale dhe informatike.

shkencave - _____

ndihmon - _____

të cilat - _____

dhe - _____

1 pikë

VUAJTJET E DASHURISË

Paqë, jo, nuk gjej, e luftë s'kam me njeri,
Kam frikë e shpresë, digjem e akulloj,
Në qiell fluturoj, por prapë në tokë rri,
S'përqafoj kënd e botën në krahë pushtoj.

Rob i saj jam, s'më kyç as jep liri,
S'më do për vete e lakut s'i dredhoj,
S'më vret e prangat më lë kjo dashuri,
Të gjallë s'më do e s'mundem t'i shpëtoj.

Shikoj pa sy, gjuhë nuk kam e bërtas,
E dua të vdes, e prapë kërkoj ndihmë;
Veten urrej, ndërsa të huajin dua.

Dhimbja më ushqen e vaji më del me gaz;
As jeta as vdekja s'më pëlqejnë një grimë,
Në këtë gjendje jam nga ti, o grua!

17. Kush është autori i poezisë VUAJTJET E DASHURISË?

1 pikë

18. Pranë konstatimit të saktë rretho shkronjën S, e pranë të pasaktës shkronjën P dhe arsyetoje përgjigjen.

KONSTATIMI	SAKTË PASAKTË	ARSYETO PËRGJIGJEN
VUAJTJET E DASHURISË është sonet.	S P	
Vjersha ka motiv dashurie.	S P	
Vjersha transmeton qetësi shpirtërore.	S P	

1 pikë

19. A) Cilën figurë stilistike e dallon në vargun e veçuar?

„Paqë, jo, nuk gjej, e luftë s’kam me njeri“

1 pikë

B) Sqaro funksionin e kësaj figure stilistike.

_____ 1 pikë

20. Shkruaje emrin e personazhit letrar që kërkohet.

1. Si quhet princi i Danimarkës i cili në një tragjedi të Shekspirit bën pyetjen: „Të rrosh a të mos rrosh - kjo është çështja“?

2. Si quhet kryepersonazhi i romanit KRIM E NDËSHKIM?

3. Cili është personazhi kyç i komedisë PAS VDEKJES të Çajupit, emrin e të cilit autori e jep në një formë - si me tallje?

2 pikë

21. Kishte parë në ëndërr se ai kali i tyre tërhiqej, ja kështu nga turmat, drejt qytetit, por kjo tërheqje ishte një krusmë e pafund.

Në cilën rasë janë fjalët e nënvizuara?

i tyre - _____

qytetit - _____

një krusmë - _____

1 pikë

22. Në tekstin më poshtë korrigo saktë shkronjën “ë”, duke vendosur dy pika mbi shkronjën “e”, aty ku duhet.

Ne sallën solemne të Qendres Kulturore Informativë “Malesia” në Tuz, mbremë u organizua prezantimi i librit “Komunikojmë dhe hartojmë përdorimin e gjuhës” të autorit Bahri Beci.

1 pikë

23. A) Ndër format e fjalëve të shënuara më poshtë nënvizo ato që janë normative në gjuhën e sotme (standarde) shqipe:

xhvesh - zhvesh ; shpik - çpik ; (i,e) lezetshëm – (i,e) lezeçëm

1 pikë

B) Fjalët e dhëna në njëjës kaloji në shumës.

mashkull - _____

thes - _____

fyell - _____

1 pikë

24. Pranë emrit të personazhit letrar shkruaje titullin e veprës letrare ku paraqitet dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të veprës.

Beatriçja _____

Vlladika Danillo _____

Kreonti _____

Zonja Johansson _____

2 pikë

25. A) Cili nga tiparet e dhëna **NUK ËSHTË NË PËRPUTHJE** me tiparet e tjera të drejtimit letrar për të cilin bëhet fjalë?

1. rrëfimi në vetën e tretë (er-forma)
2. njeriu i vogël
3. motivi social
4. letërsia popullore si frymëzim

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

B) Argumento përgjigjen.

1 pikë

26. Pranë emrit të personazhit nga *Iliada* e Homerit shkruaje epitetin e përhershëm të tij në këtë poemë. Kujdes, nuk ka nevojë për dy epitete.

Epitetet e përhershme: krahëbardha, gishttrëndafiltë, tarogzëtundësi, këmbëshpejti

Hektori _____

Akili _____

Andromaka _____

1 pikë

Pyetjet 27, 28 dhe 29 kanë të bëjnë me një vepër letrare të obligueshme.

27. Veprën *I HUAJI* e ka shkruar:

1. Gustav Flobert
2. Franc Kafka
3. Albert Kamy

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

28. Kur ishim në morg, më tregoi se kishte hyrë në azil nga nevoja. Meqë ndihej mirë me shëndet, kishte kërkuar të punonte si portier. Unë i thashë se, tek e fundit, ai ishte pjesëtar i azilit. Më tha se jo. Më kishte bërë përshtypje mënyra si thoshte: “ata”, “të tjerët” dhe më rrallë “pleqtë”, kur fliste për pleqtë e azilit, disa prej të cilëve nuk ishin më të moshuar se ai. Por sigurisht nuk ishte e njëjta gjë. Ai ishte portier dhe në njëfarë mase kishte të drejtë mbi ta.

(Fragment nga vepra “I huaji”)

A) Ndikimet e cilës rrymë filozofike (ose rryme moderne letrare) vërehen në krijimtarinë e këtij autori?

1 pikë

B) Përse kishte hyrë portieri në azil?

1 pikë

C) Çka i bënte përshtypje narratorit?

1 pikë

29.

Autori i romanit *Viti i Gucisë*, Zuvdi Hoxhiqi Berisha, është një krijues me prirje të dalluar, i cili të thuash përnjëherë dhe papritmas zuri një nga vendet e rëndësishme në prozën bashkëkohore të vendit. (...) *Viti i Gucisë* është vetëm një roman i hidhur për kohë të hidhura. (...) Në pjesën e parë, sado të realizuar me sukses, autori ka mungesa e dobësi, iluzione të vogla. Pjesa e dytë shtron mundësinë që ai të thellohet edhe më shumë në këtë botë të ndërlikuar njerëzish dhe fatësh, gërshetimesh të ndryshme, sidomos në përkim me kohën e re dhe botëkuptimet rrënjësisht të ndryshuara për raportet ndërmjet njerëzve.

Hasan Mekuli

Teksti i Hasan Mekulit bën pjesë në letërsinë artistike apo atë shkencore/joartistike (teori e letërsisë, histori e letërsisë, kritikë letrare)? Argumento përgjigjen.

2 pikë

30.

Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

1. “KOPRRACI”

Udhëzime për shkrimin e esesë.

Shkruaj për:


- Autorin e veprës "Koprraci", periudhën, gjininë dhe llojin letrar të cilit vepra i takon.
- Me çfarë vesi shfaqet figura e Harpagonit në vepër?
- Dukurinë e *harpagonizmit*, në çfarë mënyre na mëson Molieri duke na argëtuar?
- Intrigën që i bën Klearti babait të vet, arsyet e tij dhe dyshimin e Harpagonit që i çmend të gjithë?
- Ku në tekst shfaqet si një përfitues i pafytyrë? Argumento përgjigjen tënde.

2. (PA)KULTURA E TIFOZËVE

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Shprehe qëndrimin tënd çfarë afirmon dhe ku kontribuon sporti si aktivitet.
- Çdo ditë jemi dëshmitarë të sjelljes së dhunshme të tifozëve. Shprehe mendimin tënd lidhur me këtë problem.
- Thuaje mendimin tënd mbi shkaqet e shfaqjes së shpeshtë të dhunës në ndeshjet e sportit.
- Shprehu, duke sjellë shembuj nga përvoja jote personale ose nga mediat, për:
 - marrëdhënien problematike të tifozëve ndaj tifozëve të tjerë, gjegjësisht grupeve të tjera të tifozëve.
 - marrëdhënien problematike të tifozëve ndaj sportistëve të skuadrave kundërshtarë, arbitrave, gazetarëve, kalimtarëve në rrugë...
- Deklarohu dhe argumentoje mendimin se dhuna në sport është / nuk është model i sjelljes për të rinjtë.
- Thuaj çfarë pasojash mund të ketë dhuna në ndeshjet sportive.
- Si përfundim, propozoj cilat masa do të mund të parandalonin vandalizmin dhe huliganizmin në fushat e sportit, gjegjësisht në mes grupeve të tifozëve.

25 pikë



2

2

3

3

4

4

5

5

6

6

7

7

8

8

9

9

10

10

11

11

12

12

13

13

14

14

15

15

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9